

27.08.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-147034

Data: 22.08.2025

Prizren

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN, me kërkesën e **REGB SHPK Prizren** në rrugën “Tranziti” pn., me të cilën ka kërkuar leje për realizimin e pusetave energjetike, ndertimin e linjes ajrore kabllore 10(20)kV nga shtylla te vjetra ne te reja,trafostacionit te ri 1000kvA 10(20)/0.4kv dhe rrjetit TU, në bazë të nenit 3 paragrafi 1 pika 1.1, 1.4, 1.24, si dhe nenit 5, paragrafit 1.1 e lidhur me nenit 15 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Ndërtim numër 04/L-110, nenit 3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 – Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 si dhe konform nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44, 46, 47, 48 dhe nenit 125 të L.P.P.A numër 05/031 të datës 25. 05. 2016 si dhe neni 142 paragrafi 3 vendimit Komunal për Rregullimin e qytetit dhe të shërbimeve komunale numër 01/011-2 data 18. 11. 2004 merr këtë:

A K T V E N D I M

I LEJOHET: REGB SHPK Prizren në rrugën “Tranziti” pn., me të cilën ka kërkuar leje për realizimin e pusetave energjetike, ndertimin e linjes ajrore kabllore 10(20)kV nga shtylla te vjetra ne te reja,trafostacionit te ri 1000kvA 10(20)/0.4kv dhe rrjetit TU, (sipas skicës së gjeodetit nr.125 Faton Bajselmani) në ngastra kadastrale 05091-19 dhe PSH.KK Prizren 05061-5,04934-2 Z.K.Prizren.

Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.

I. Vendosija e infrastruktures të bëhet sipas dokumentacioni teknik. me të cilat janë definuar parcelat në aktvendim.

II. Te gjitha problemet pronësore juridike në përgjegjësi të mbeten vetë investitorit

- Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektë e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave teknike për kësi llojë punime.

Kjo Leje bazohet në shqyrtimin e provave:

- Informate pelqim/zgjidhje nga KEDS NR. .tik.1890372 lenda 06(6)2025 nr.406
- Sipas pelqimit të Drejtorisë Shërbimeve Publike Nr. 05-343/01-59569/25 të dt.16.05.2025
- Sipas pelqimit Hidroregjioni Jugor Nr. 84646 të dt.16.05.2025
- Sipas pelqimit PTK Vala me nr.141/2025 të dt.23.05.2025.
- Ti përmbahen të gjitha pelqimeve të cilat janë të shkruara që ekzekutimi i punimeve të bëhet me kujdes me njoftime të cekura në keto pelqime.

III. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures teknike të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet

qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.

IV. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës

V. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendin menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme dhe cdo demtim obligimi mbetet investitorrit.

VI. Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkoj nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.

A r s y e t i m

REGB SHPK Prizren në rrugën “Tranziti” pn., me të cilën ka kërkuar leje per —realizimin e pusetave energjetike,ndertimin e linjes ajrore kabllore 10(20)kV nga shtylla te vjetra ne te reja,trafostacionit te ri 1000kvA 10(20)/0.4kv dhe rrjetit TU, (sipas skicës se gjeodetit nr.125 Faton Bajselmani) ne ngastra kadastrale 05091-19 dhe PSH.KKPrizren 05061-5,04934-2 Z.K.Prizren.

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s’bashku me kërkesë vërtetohet se:


Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për vendosje - realizimin e pusetave energjetike,ndertimin e linjes ajrore kabllore 10(20)kV nga shtylla te vjetra ne te reja,trafostacionit te ri 1000kvA10(20)/0.4kv dhe rrjetit TU Nga se u tha më lartë uvendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor-Prishtinë.


Ankesa taksohet me 0,50 Euro taksa administrative.

Bashkëpunëtor profesional:



Zana Belloda, inxh. dip. ark.

DREJTORI:



Pranverim Berisha, jur. dip.